



REPUBLIKA SHQIPERISE
KESHILLI KOMBETAR I UJIT
Keshilli I Basenit Ujembledhes Mat

VENDIM

Nr. 07 Datë 02.06.2012

“Për Përdorimin me leje të rezervës ujore nga subjekti HEC Ulez”

Per HEC Ulez.

-Në mbështetje të neneve 8 dhe 21 pika “c” të ligjit Nr 8093, datë 21.03.1996 “Për rezervat ujore”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 27 datë 19.01.2007 “Për miratimin e rregullave të vlerësimit dhe dhënies së koncesioneve”, VKM Nr. 87 datë 16.01.2008 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin Nr 27 datë 19.01.2007 “Për miratimin e rregullave të vlerësimit dhe dhënies së koncesioneve, Udhëzimit të përbashkët të M.M.P.AU dhe M.E.T.E Nr. 727 datë 07.05.2007 dhe Nr. 3252 datë 02.05.2007, Vendimit të Këshillit Kombëtar të Ujit Nr. 3 datë 19.07.2002 “Për miratimin e rregullores së funksionimit të Sekretariatit Teknik të KKU-së, Këshillit të Basenit Ujëmbledhës dhe Agjencise së Ujit”, Këshilli i Basenit Ujëmbledhes Mat :

VENDOSI:


1. Të kalojë për kompetencë dokumentacionin e subjektit HEC Ulez, për ne Sekretariatit Teknik të Këshillit Kombëtar të Ujit, në lidhje me dhënien e Lejes për përdorim Uji nga KKU /Te miratoje kërkesen në lidhje me dhënien e Lejes për përdorim Uji nga KBU Mat, sipas kërkeses së datës 23.02.2012 me keto të dhëna:

Kuota VM 128.5m, Kuota HEC-it 75,5m, Qmes=44,5m³/sek, Qllog=72m³/sek,

Prurjet për nevoja publike, ekologjike etjere përcaktohen sipas kontratave, kërkesave dhe standarteve të përcaktuara me ligj, Fuqia e instaluar P=25MW.

2. Ngarkohet AUB Mat për zbatimin e këtij vendimi dhe lidhjen e kontratës me subjektin Ndermarrja shtetërore HEC ULEZ sha.

PERGJEGJESIA A.U.B. MAT
Pashk NDOCI



KRYETARI I K.B.U. MAT
Pal DAJCI

